



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 50/16

Prishtinë, më 29.03.2016, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Arta Rexha - Rrokum-TV, Fjolla Uka-KDI, Albulena Mavraj-A.Movin-Epoka e Re.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 23.03.2016 dhe 24.03.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendin e ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 23.03.2016 dhe 24.03.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-55 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamente të Komisionit funksional për mbikshyrjen e Financave Publike

Kryetari – theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Safete Hadergjona – kam vërejtje në projektligj, dhe përkundër amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, nuk është arritur që të rregullohen disa qështje që përmban projektligji. Me projektligj është thënë se themelohet zyra kombëtare e auditimit, duke mos përmend fare zyrën aktuale të auditorit të përgjithshëm që është funksionale dhe është vlerësuar edhe jashtë vendit. Krahësuar me shtete e regjionit në aspektin e auditimit kemi qenë më së miri, kjo është thënë edhe në konferencat regjionale të cilat i kemi mbajtur. Pra është dasht me një nen atë me e rregullue këtë që tash e tutje do ta merr emrin zyra kombetare e auditimit por është vazhdimësi e zyrës së mëparshme.

Mënyra e vazhdimit të mandatit të auditorit të përgjithshëm në rast se nuk zgjidhet me kohë, përmes rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nuk është në rregull. Po ashtu një amendament i komisionit funksional lidhur me auditimin e subjekteve politike nga zyra e auditorit, është dasht të analizohet dhe krahasohet me ligjin për financimin e subjekteve politike, sepse edhe atë kjo qështje rregullohet. Në nenin 4, thuhet Auditori i Përgjithshëm është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative dhe nuk i nënshtrohet urdhrës ose ndikimit nga cilido person apo institucion tjetër, që lenë të kuptojmë se po krijojmë një monark që nuk i jep llogari askujt. Kam edhe vërejtje tjera, në përmbajtjen e projektligjit, por nuk jemi komision funksional për këtë ligj e nuk kemi drejtë me ndërhy në këto pjesë.

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me Gjashtë vota Për, Një Kundër, Asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për Projektligjin nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Të ndryshme

Kryetari – ngriti dy qështje. Qështja e parë, ka të bëjë me financimin e RTK-së. Komisioni funksional është duke e punuar në ndryshimin e ligjit, dhe në momentin kur të vijen në mund të përballemi me disa telashe siq i kemi pas gjatë shqyrtimit të buxhetit. Prandaj, unë mendojë që kishte me qenë mirë që ne të bëjmë një hulumtim legjislativ lidhur me qështjen e rregullimit ligjor dhe financimit të RTK-së, për të parë metodat e financimit përmes parapagimit, duke marr parasysh edhe vedimin e gjykatës kushtetuese lidhur me ndalesën që është bërë përmes fakturave të KEK-ut, të analizohet praktikën e vendeve të rajonit sa i përket financimit të mediumeve publike, dhe të kemi disa informata si komisioni i përhershëm. Në kuadër të kësaj, RTK, ka dorëzuar në Kuvend projektin e shpenzimeve për periudhën prill-qershor 2016. Mirëpo, nuk është dorëzuar raporti për tremujorin e parë të shpenzimeve, siq kërkohet me Ligjin e Buxhetit dhe siq kemi kërkuar edhe ne si komision kur kemi nxjerrur rekomandimet për

programin e shpenzimeve të RTK-së për periudhën janar-mars 2016. Në momentin kur RTK sjell raportin tremujor, atëherë ne e radhisim për shqyrtim projektet për tremujorin e dytë.

Qështja e dytë ka të bëjë me sistemin e raportimit. Ne kemi caktuar deputetë raportues sipas fushave dhe tash jemi në këtë fazën ku kërkohet monitorimi i buxhetit sepse është koha e procedimit të realizimit të projekteve kapitale dhe kishte me qenë mirë të involvohemi në këtë proces, për të parë se a po realizohen sipas dinamikës dhe procedurave të rregullat, që mos të kemi pastaj probleme gjatë shqyrtimit të buxhetit.

Besa Gaxherri - lidhur me monitorimin e buxhetit, ne e kemi lënë që me na ndihue projekti i GIZ-së, sidomos me ekspertë dhe është vështirë që të monitorojmë pa mbështetje profesionale. Po e marr fushën shëndetsisë ku jam caktuar unë, është një fushë e komplikuar, prandaj kemi nevojë për mbështetje me ekspertizë.

Kryetari – ka qenë ideja, që të angazhohen disa studenta në mbështetje të deputetëve, por meqë kërkesa e deputetëve është për ekspertë, do të bisedojë me udhëheqësen e Projektit të GIZ-së, znj. Aleksandra, për të parë mundësitë që ofron projekti.

Bardhyl Meta – njoftojë deputetët se grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për akcizën në produktet e duhanit, është duke pritur hulumtimin legjislativ nga KDI, ku kemi parashtruar tri qështje. Qështja e parë, po duam me lobue që me kthye kulturën e kultivimit të duhanit për të cilën Kosova ka pasur një traditë të mirë. KDI është pajtuar që në kuadër të hulumtimit të financojë dy tryeza, që do të mbajmë në Gjakovë edhe Gjilan, për ti involvuar dhe diskutuar me të gjitha grupet e interesit. Pjesa e dytë ka të bëjë me asistencën tonë në qështjen e akcizës së duhanit, që eventualisht me ba kategorizimin e akcizës, siç është edhe në vende tjera. Do të organizojmë edhe dëgjimin publik dhe shumë shpejtë do të fillojmë me takime.

Kryetari – një qështje që nuk kemi arritur me pas rezultat si grupi punues është qështja e hartimit të Projektligjit për institucionet mikrofinanciare. Këtë qështje e kam ngritur në takimin e fundit që e kemi pasur me kryetarin e kuvendit dhe kryetarët e komisioneve funksionale dhe kam kërkuar mbështetje nga administrata, pasi që nuk po arrijmë të gjejmë ekspertë.

Safete Hadergjona - është e vërtetë që po kemi problem me këtë ligj dhe shohim se për çdo ditë po shtohen këto mikrofinanca dhe më e keqja është se në kuadër të këtyre mikrofinancave janë duke u shtuar edhe OJQ-të që e kanë pas statusin e mikrofinancave dhe të cilat kanë pas refleksione negative në tërë shoqërinë tonë. Ne faktikisht e kemi pasë një draft që na ka ofruar Banka Qendrore dhe është mirë që ato dy apo tri pika ku janë problematike të analizohen dhe me marr ma seriozitet e me gjetë një zgjidhje. Mikrofinancat me sa kam vërejtur unë funksionojnë edhe në vende tjera, mirëpo punën e organizimit e kanë pak me ndryshe. Nëse ka nevojë, ti ndryshojmë dy ligjet, por të gjejmë një zgjidhje dhe nëse nuk e zgjedhim problemin, kjo është dobësi institucionale.

Kryetari – sa i përket ligjit në fjalë, është një detal i pazgjidhur, është qështja e trajtimit të mjeteve që janë marrë si donacion nga këto institucione. Kjo paraqet një sfidë për të gjetë një zgjidhje, pa një përvojë të ndonjë vendi që e ka kaluar këtë proces.

Besa Gaxherri - në kuadër të monitorimit të buxhetit, përveç asaj që jemi të ndarë në fusha të caktuara duhet pasur parasysh edhe monitorimin e buxheteve komunale, siç ishte rasti i buxheteve të komunave në veri. Unë mendoj se kishte qenë mirë me e përgadit një agjendë dhe me i vizitue ato komuna të veriut në aspektin buxhetor, se si po funksionojnë, duke pasur parasysh edhe vërejtjet që i kemi ba në komision dhe të shikojmë edhe anën teknike por edhe politike.

Kryetari – ne kemi biseduar edhe ne mbledhjen e komisionit, që të shkojm në këto komuna, por ta bëjmë një agjend të mirë dhe mos të jetë vetëm monitorimi i buxhetit të komunave por edhe i fondit të shpenzimeve të veriut.

Mbledhja përfundoi në ora 13:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani